

BAZAT E HIDRAULIKËS PËR SISTEMIN E FURNIZIMIT ME UJË

Përshkrimi i kursit

Hidraulika është shumë e rëndësishme kur kemi të bëjmë me një sistem furnizimi me ujë. Uji gjatë lëvizjes prodhon forcë dhe presion sa herë që shpejtësia, drejtimi i prurjes ose lartësia ndryshon. Duke ditur presionin dhe prurjen në një pikë të caktuar të tubacionit, na ndihmon të gjejmë përmasat e tubacionit dhe kapacitetin e tij. Gjithashtu na ndihmon të gjejmë llojin e materialit të tubacionit që na nevojitet në një situatë të caktuar.



Për më tej, të kesh njohuri të mira të hidraulikës, i ndihmon menaxherët të vendosin nëse reduktuesit e presionit ose pompat janë të nevojshëm për transmetimin e ujit në mënyrë efektive.

Ky kurs trajnimi do të ofrojë konceptet bazë të hidraulikës në një sistem furnizimi me ujë, nga burimi tek rubineti.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për inxhinierët dhe teknikët.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Njihni parimet themelore të presionit;
- Llogarisni presionin në bar dhe kPa;
- Identifikoni humjet në presion;
- Identifikoni humbjet në fërkim;
- Identifikoni humbjet në pajisjet e tubacioneve;
- Llogarisni kuajt fuqi të pompës dhe eficientë;
- Llogarisni shkallën e prurjes;
- Identifikoni pajisjet për matjen e prurjes.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Bazat e Hidraulikës për Sistemin e Furnizimit me Ujë". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.